Mundesi zgjedhje per te pakten tre nivele frekuence funksionimi dhe te pakten tete harta ngjyre.

Perseritja e pulseve ne intervalin minimal 0.1 deri ne 25KHz

Filter automatik ndaj artefakteve te levizjes se eneve te gjakut me te pakten kater shkallezime.

Doppler Fuqie.

Mundesi zgjedhje per te pakten tre nivele frekuence funksionimi dhe te pakten tete harta ngjyre.

Perseritja e pulseve ne intervalin minimal: 0.1KHz deri ne 20KHz.

Doppler Spektral i Pulsuar.

Perseritja e pulseve ne intervalin minimal: 1KHz deri ne 20KHz

Korrigjimi i kendit te kampionit jo me pak se $\pm 85^\circ$

Matja e shpejtesise duke filluar nga 1cm/s deri ne 1600cm/s.

Dallim automatik i spektrit dhe matje spektrale ne kohe reale.

Te perfshihet software per matjen automatike, ne kohe reale te parametrave doppler.

Modalitet Levizje

Fuqia ultrasonike e rregullueshme.

Mundesi zgjedhje per te pakten 5 harta gri

Mundesi shfaqe te imazhit ne modalitet levizje sebashku me imazh Bi-Dimensional

Modalitet 3D/4D

Skanim volumetrik tre-planar dhe 3D ne kohe reale (4D)

Software dhe funksione shtese qe duhet te perfshihen ne konfigurim:

- Pakete e plotes software per te gjitha matjet Obstetrike dhe Gjinekologjike
- Modalitet skanimi 3D dhe 4D ne kohe reale
- Funksion tomografik per shume plane paralele skanimi. Ndryshimi i prerjeve tomografike nga 0.5 deri ne 10mm.
- Software per uljen e artefakteve ultrasonike dhe per rritjen e kontrastit te imazhit

Sondat e perfshira:

- Sonde konvekse obstetrike 2D me interval frekuence minimale 2÷5 MHz dhe fushepamje 55°
- Sonde endokavitare gjinekologjike 2D me interval frekuence minimale 4÷9 MHz dhe fushepamje deri ne 160°.
- Sonde konvekse obstetrike volumetrike 3D/4D me interval frekuence minimale 2÷6 MHz. Fushepamja minimale 3D/4D: 80° x 70°.

Karakteristika te tjera dhe aksesore:

Database per pacientet dhe te dhenat e ekzaminimit me kapacitet minimal memorie 500GB.
Pergatitje raportesh me mundesi te perfshirjes se imazheve. Te perfshihet protokolli DICOM.
Pajisur me nderfaqje: USB, HDMI, VGA, Ethernet (import/export te dhenash), Audio.
Printer termik A6 bardh e zi i integruar
Furnizimi me energji: 220VAC/50Hz.

5 Eko obstetrike gjinekologjike portabel per urgjencen

Të jetë e përshtatshme për ekzaminimet abdominale, gjinekologjike, obstetrike, pediatrike me dy sonda dhe me aftesi skanimi 4D.

Pajisur me karrel me 4-rrota dhe me lartesi te rregullueshme.

Të ketë përpunim me te pakten 200.000 kanale dixhitale

Të ketë ekran me ngjyra, me teknologji LED dhe rezolucion minimal 1920 x 1024 pixel.

Madhësia e ekranit diagonal të jetë jo më pak se 15 inch.

Këndi i shikimit vertikal dhe horizontal të paktën 160° per ekzaminime endovaginale.

Pajisur me të paktën 3 porta për sondat konvekse, lineare, vellimi etj.

Thellësia e skanimit duhet të garantohet deri në 32 cm

Frame rate të jetë mbi 1700 fps

Diapazon i lartë dinamik deri ne 260 decibel.

Modalitetet e skanimit te jene si më poshtë:

Modaliteti B, M-Mode, Color Doppler, Power Doppler, PW Doppler, Doppler Indor, Modalitet 3D/4D.

Modaliteti B

Te kete mundesi selektimi per te pakten 5 harta gri

Te perfshije funksionet e rregullimit te amplifikimit dhe diapazonit dinamik

Modaliteti Doppler me ngjyra (Color Doppler)

Ndryshimi i pjerresise se kendit nga 0 deri ne 20°

Frekuenca e skanimit te pulseve nga 0.3 deri ne 25KHz

Modaliteti Power Doppler

Funksion i rregullimit te amplifikimit

Te kete mundesi selektimi per te pakten 10 harta

Frekuenca e skanimit te pulseve nga 0.3 deri ne 25KHz

Modaliteti Doppler Spectral PW

Korrigjimi i këndit i rregullueshem te pakten ne diapazonin 0-90°

Frekuenca e skanimit te pulseve nga 0.3 deri ne 25KHz

Shkalla e shpejtesise nga 0.1cm/s deri ne 70m/s
Dritare kampionimi 1-15mm
Modaliteti Motion (levizje)
Funksion i rregullimit te amplifikimit
Të ketë mundësi selektimi për të paktën 5 harta te ndryshme
Modalitet skanimi 3D/4D
Mundesi skanimi per volum 3D dhe 4D
Mundesi skanimi volumetrike tomografike me 5-15 prerje
Distanca midis prerjeve tomografike 0.5 deri ne 40mm
Të përfshihen paketat e meposhtme ne menyre permanente:
Paketa e plotë e matjeve: Abdominale, gjinekologjike, obstetrike,pediatrike, pjesët e vogla.
Te perfshihet ne menyre permanente modaliteti i skanimit 3D/4D.
Te perfshihet software filtrimi per permiresimin e imazheve
Karakteristika të tjera:
Te kete memorie te pakten 256 GB me teknologji SSD ose ekuivalente.
Funksion raportimi me mundësi integrimi të imazheve.
Ndërfaqje: USB, HDMI, Ethernet, audio e integruar.
Te jete e pajisur me bateri te integruar
Furnizimi me energji: 220VAC/50Hz
Sonda dhe aksesore të përfshirë:
• Sonde abdominale me shkallë frekuence min. 2÷5 MHz dhe fushepamje minimale 55°.
• Sondë gjinekologjike me shkallë frekuencë min. 4÷10 MHz dhe fushepamje minimale 160°.
• Printer videobardh e zi i montuar ne karrel

6 Llampe anesore (mobile)

Llampe per procedura ekzaminimi mjekesor dhe kirurgji minore.
Llampe ekzaminimi LED .
Tub fleksibel mbi baze te levizshme me 5 rrota
Lartesi e rregullueshme
Llampe me hijezim te reduktuar
Jetegjatesia e LED-it jo me pak se 50,000 ore
Diametri I satelitit jo me pak se 190 mm
Me doreze te sterilizueshme
Temperatura e ngjyres rreth 4500 K
Intensiteti ne 0.5 m mbi 100000 lux
Diametri i fushes se drites ne 50 cm largesi min 14 cm

7 Llampe ekzaminimi (spot)

Llampe ekzaminimi LED
Tub fleksibel mbi baze te levizshme me pese rrota
Lartesi e rregullueshme
Temperatura e ngjyres min. 4200 K
Intensiteti ne 0.5m: min 30000 Lux
Jetegjatesia e LED-it jo me pak se 50,000 ore

8 Set abrazio

Pincete kirurgjie fine 1x2 dhembe 23 cm
Pincete foerster e harkuar zigr. 24,5 cm
Speculum vaginal collin 85 x 30 mm
Speculum vaginal collin 100 x 35 mm
Speculum vaginal collin 110 x 40 mm
Speculum vaginal kallmorgen 90 x 40 mm
Valvula vaginale kallmorgen 90 x 37 mm
Speculum vaginal doyen 118 x 35 mm
Diverikator vaginal breisky 100 x 40 mm
Diverikator vaginal breisky 130 x 25 mm
Dilatator uterin hegar 3,0 mm
Dilatator uterin hegar 4,0 mm
Dilatator uterin hegar 5,0 mm
Dilatator uterin hegar 6,0 mm
Dilatator uterin hegar 7,0 mm
Dilatator uterin hegar 8,0 mm
Dilatator uterin hegar 9,0 mm
Dilatator uterin hegar 10,0 mm
Dilatator uterin hegar 11,0 mm
Dilatator uterin hegar 12,0 mm
Dilatator uterin hegar 13,0 mm
Dilatator uterin hegar 14,0 mm
Dilatator uterin hegar 3,5 mm
Dilatator uterin hegar 4,5 mm
Dilatator uterin hegar 5,5 mm
Dilatator uterin hegar 6,5 mm
Dilatator uterin hegar 7,5 mm
Dilatator uterin hegar 8,5 mm
Dilatator uterin hegar 9,5 mm
Dilatator uterin hegar 10,5 mm
Dilatator uterin hegar 11,5 mm
Dilatator uterin hegar 12,5 mm
Dilatator uterin hegar 13,5 mm
Dilatator uterin hegar 14,5 mm
Histerometer sims 33 cm, fleksibel
Pince per uterusin schroeder 25,5 cm
Pince per uterusin braun 26 cm
Pince schroeder e drejte 25 cm unc.e dyfishte
Kyrete novak 24,5 cm prej 4 mm
Kyrete uterine rixhide presese 30,5cm 6mm
Kyrete uterine rixhide presese 30,5cm 8mm
Kyrete uterine rixhide presese 31,5cm 12mm
Kyrete uterine rixhide presese 32cm 16mm
Kyrete uterine rixhide presese 32cm 20mm
Kyrete uterine rixhide presese 34cm 25mm
Kyrete uterine fleksibel presese 32cm 20mm

Kyrete uterine fleksibel presese 32cm 23mm
Kyrete uterine fleksibel jo-presese 31cm 9mm
Kyrete uterine fleksibel jo-presese 31cm 11mm
Kyrete uterine fleksibel jo-presese 32cm 15mm
Kyrete uterine fleksibel jo-presese 32cm 16mm
Kyrete uterine fleksibel jo-presese 32cm 19mm
Kyrete per aspirim 12 mm
Kyrete per aspirim 14 mm
Tas celiku inox 80 x 40 mm
Kontenitor microstop 60x30x11 cm
Kontenitor rrjete 480x250x60 mm

9 Set lindje

GERSHERE EPISIOTOMIE WALDMANN 18 CM	1
GERSHERE EPISIOTOMIESCHUHMACHER 15,5 CM	1
gershere . legature, crv, dent, 17 cm	1
PINCE ANATOMIKE STANDARTE 23 CM	1
PINCE TC OEHLER 18 CM E DHEMBEUAR	1
PINCE TC OEHLER 25 CM E DHEMBEUAR	1
PINCE BENGOLEA E HARKUAR 26 CM E DHEMBEUAR	1
PINCE KOCHER (OCHSNER) E HARKUAR 18,5 CM	2
PINCE ROBERTS 22 CM E HARKUAR	2
PINCE FOERSTER E DREJTE ZIGR. 25 CM	2
PORTAGE TC MAYO-HEGAR 18 CM	2
PORTAGE TC MAYO-HEGAR 24 CM	1
SPEKULUM VAGINAL DOYEN 118 X 35 MM	1
SPEKULUM VAGINAL DOYEN 120 X 47 MM	1
SPEKULUM VAGINAL DOYEN 85 X 60 MM	1
TAS CELIKU INOX 128 X 55 MM	1
BACIN.RENIF.ACCIAIO INOX 250X140X40 MM	1
KONTENITOR MICROSTOP 30X30X14 CM	1
KONTENITOR RRJETE240X250X60 MM	1

10 Stativa

Stativa serumi me strukturë inoksi, me lartësi maksimale rreth 2m, të rregjistrueshme/të rregullueshme, me bazament plastikë të zezë me 5 këmbë me rrota, dhe me 4 grepa për varjen e mbajtëses së serumit.

11 Laringoskop adult

Set laringoskopik me fiber optike dhe llampe LED
Te perfshihen Lama McIntosh 2,3,4
Te jete me doreze me bateri
Te gjitha materialet te jene metalike te pa oksidueshme

12 Laringoskop pediatrik

Set laringoskopik neonatal me fiber optike dhe llampe LED
Te perfshihen Lama McIntosh 0 (premature) dhe Miller 0, 1
Te jete me doreze me bateri
Te gjitha materialet te jene metalike te pa oksidueshme

LOT 3 - "F.V pajisje hotelerie spitalore për Maternitetin e Ri në Sp Lezhë"

1. Karrel instrumentash Kirurgjikal

Karrele prej materiale celik stainless (jo i ndryshkshem), me doreze per shtyrje, me 3 rafte dhe me rrota ne kater mbajteset. Dimensionet 70x50x80 cm, te suportoje peshe jo me te voges se 25 kg

2. KREMAT REANIMACIONI

Krevati duhet të sigurojë lëvizje të paktën në tre seksioneve të bazamentit të krevatit përkatesisht zonës së sipërme të krahërorit, pjesës së barkut dhe këmbëve, rregullim të lartësisë, pozicioneve vasculare te cilet kontrollohen nga minimum 3 motorë

Pozicionet të kontrollohen nga panelet e kontrollit të vendosura në anët e jashtme të kufizueseve anësore

CPR elektrike dhe karakteristikat e mbylljes së funksionit në kontrollin e mjekut (në anën e jashtme të kufizueseve anësore)

Kreu dhe fundi i këmbëve të krevatit jane prej polipropilenit (PP) i cmontueshem (opsion me panele me ngjyra)

Binarët e ndarjes plastike PP me lëvizje të butë me treguesin e këndit minumi 4 pjesë të pavarura dhe të ndashme ABS

Kornizë çeliku të veshur me pluhur elektrostatische antibakteriale ABS .

Me rrota me rrotullim 360 ° me sistem frenimi dhe bllokim te drejtimit
Adaptorë aksesorë në qoshe, mbajtëse serumi e rregullueshme me lartësi
Mbajtësit e qeseve të urinës dhe grepa rrip në të dyja anët
Aksesor plastike mbrojtës në qoshet
Opsionet alternative të ngjyrave për binarët anësorë

Dyshek me shkumë të dendur me mbulim antibakterial, të papërshkueshëm nga uji dhe me zippered

3. KRE VAT VIZITE GJINEKOLOGJIKE

Shtrat vizitash me përmasa gjatesi 172 cm, gjerësi 60 cm dhe lartësi 75 cm (nga pjesa e dyshekut ne pjesen e trupit deri ne toke).

Dysheku të jetë i ndarë në dy pjesë: pjesa e kokës e cila ka mundësi të lëvizë në disa pozicione, e paisur me dyshek të veshur me material rezistent kundra zjarrit, antibakterial dhe lehtësisht të pastrueshëm, me përmasa 50 cm dhe gjerësi 60 cm.

Pjesa fikse e trupit dhe këmbëve me dimensione 122 cm dhe gjerësi 60 cm.

Në pjesen e poshtme të cdo kembe të ketë mbeshetëse plastike e cila ben kontaktin me tokën.

4. Krevat manipulime gjinekologjike

Krevat Ekzaminimi gjinekologjik me 3 ndarje

Mbeshetësja e kokës dhe kembëve te jete e rregullueshme

Permasat afersisht 60x180x80cm

Mbuluar me lekure sintetike ne pjesen e jashtme, lehtesisht e pastrueshme dhe qe duron nxehtesine

Strukture metalike e kromuar ne te kater kembet

Me mbajtëse kembesh dhe bacinele

Lëvizja e shpines , lëvizja lart-poshte, tredelenburg/reverse tredelenburg të kontrollohen ne menyre elektrike.

Shasia e metalit të jetë poliesteri e ngjyrosur elektrostatisht

Pjeset e kokës dhe këmbës së shtratit të jenë të shkëputshme.

Të ketë 4 vrima serumi IV në 4 qoshet e shtratit të pacientit dhe një pol të rregullueshme IV.

Të ketë 4 bumpers në 4 qoshet e shtratit të pacientit.

DIMENSIONET:

- Gjatësia e plotë: 210 cm
- Gjerësia e plotë: 101 cm
- Gjatësia: 48 cm
- Madhësia e dyshekut: 190 cm
- Gjerësia dyshek: 80 cm
- Kapaciteti Pështa: 180 kg

3. LEVIZJET KENDORE

- Lëvizja e pasme: 0 ° -60 °
- Lëvizja e pjeses se gjurit: 0 ° -30 °
- tredelenburg/reverse tredelenburg 0°-12°

4. DYSHEKU

- Veshje papërshkueshëm nga uji dhe i zipuar,
- I përshtatshëm për të gjitha lëvizjet

5. SISTEMI I LEVIZJES DHE FRENIMIT

Ø125 mm, rotativ me kthesë 360 °

5. Krevat lindje

E ndare ne tre seksione: shpina, ndenjesja dhe kembet

Me tre motore per rregullim elektronik te lartesisë, shpines dhe pozicioneve

Tredelenburg/Reverese Trendelenburg.

Komandim nga nje panel kontrolli dhe/ose telekomande.

Pjesa e kembeve e zmontueshme lehtesisht.

Tredelenburg / Reverse Trendelenburg

Dyshek me tre seksione, me materiale antimikrobiale, rezistente ndaj ujit, te padjegeshme, te respirueshem, dhe lehtesisht te pastrueshem

Bazamenti / platforma e dyshekut prej materiali ABS.

Shina anesore (te zmontueshme) prej celiku inox ne seksionin e ndenjeses, destinuar per montim aksesoresh.

Pjesa e shtrirje (dysheku) i mbushur me shkume-gome per te ndjekur formen anatomike te trupit.

Amortizatore goditjesh gjate levizjeve.

Lartesia e shtratit e rregullueshme ne diapazonin 60 deri 85 cm

Siperfaqe e krevatit; gjatesia min 185 cm, gjeresia min 80 cm.

Seksioni i shpines i rregullueshem nga 0 ne 70 deg.

Tredelenburg i rregullueshem deri ne rreth +/- 6 deg.

Reverse Trendelenburg i rregullueshem deri ne rreth +/- 12 deg.

Funkcion CPR manual

Aksesore:

- Mbajtese kembesh (1 cift), me veshje materiali te gomuar, me lidhese per fiksime kembesh, me konstrukcion me cerniere sferike per pozicionim kendor te rregullueshem, dhe lartesi te rregullueshme
- Mbajtese anesore te pacientit (1 cift);
- Bacinele inoksi me fiksuesin perkates (1 cope);

6. BARRELE

Konstrukcion metalik me tuba celiku të lyster me boje elektrostatische me dimensione

60x220x22cm. Të garantojë qendrueshmëri në mbajtjen e peshes deri në 190 kg. doreza mbajtese në 4 cepat e saj.

7. Shtrat patienti

Lëvizja e prapme dhe lëvizja e këmbëve të kontrollohen nga 2 manivelat në fund të kembeve

Kokën dhe tabelat e këmbëve të jenë bërë prej plastike PP

c. 2 copa binarët anësor të shkrirë janë bërë prej alumini

d. 4 copa hedhjen sipërfaqe të jetë bërë nga ABS plastike

e. Shasia e metalit të jetë poliesteri e ngjyrosur elektrostatikisht

f. Këmbët e kokës dhe këmbës së shtratit të jenë të shkëputshme.

G. Shasia e metalit të jetë poliesteri e ngjyrosur elektrostatikisht dhe i mbuluar me ABS plastike.

h. Sistemi kryq i frenave: Të ketë levat frenuese ne rrotat kryq te krevatit

j. Të ketë 4 vrima serumi IV në 4 qoshet e shtratit të pacientit dhe një pol të rregullueshme IV.

k. Të ketë 4 bumpers në 4 qoshet e shtratit të pacientit.

- l. Lëvizja e pasme kontrollohet nga foleja e majtë.
- m. Lëvizja e këmbës kontrollohet nga fiksimi i duhur.
- n. Këmbët e zbërthyera mund të montohen lehtësisht.

2. DIMENSIONET:

- Gjatësia e plotë: 210 cm
- Gjerësia e plotë: 101 cm
- Gjatësia: 48 cm
- Madhësia e dyshekut: 190 cm
- Gjerësia dyshek: 80 cm
- Kapaciteti Pesha: 250 kg

3. LEVIZJET KENDORE

- Lëvizja e pasme: 0 ° -70 °
- Lëvizja këmbë: 0 ° -30 °
- Vaskulare
- Lëvizja e gjurit

4. DYSHEKU

- Veshje papërshkueshëm nga uji dhe i zipuar,
- CNC prerë,
- I përshtatshëm për të gjitha lëvizjet
- Shkumë densitet prej 28 kg / m³

SISTEMI I LEVIZJES DHE FRENIMIT

Ø125 mm, rotativ me kthesë 360 ° me mekanizëm kryq të frenimit.

Te jete i pajisur me aksesori – Tryeze shtrati- i montueshem/cmontueshem tek mbajteset anesore

8. Krevat per bebe 120x70

Shtrati duhet te jete me permasa 120x70 duhet te jetë i fiksuar mbi një skelet metalik i ndërtuar me profile 30x30x2, i lyster me bojë me pjekje (rezistent ndaj gërvishtjeve dhe goditjeve), të ketë 4 këmbë dhe duhet të jetë i lëvizshëm në sajë të 4 rrotave (të cilat rrotullohen në mënyrë të pavarur në të gjitha drejtimet dhe të kenë mekanizëm frenues dhe bllokues) .

Lartësia e shtratit nga toka 65 cm. Platforma e shtratit duhet të jetë e përbërë nga dy pjesë, pjesa e kokës e lëvizshme me regjistrim mekanik dhe pjesa tjetër fikse. Platforma të jetë e përbërë nga një shtresë sfungjeri jo më pak se 5 cm dhe e veshur me lëkurë ekologjike (antibakterile dhe antialergjike) sipas standartit të CE, rezistente nga gërvishtjet, uji dhe e pastrueshme lehtësisht nga njollat.

9.Komodina pacienti

Përmasat(gjerësi x thellësi x lartësi): 40 x 65 x 67 cm

Komodina te kete sirtar, dere, tavoline qe zgjatet mbi krevat,Dimensionet 40x65xh67 cm, Struktura te jete material druri,Pjesa e siperme te jete material MDF,Sirtar i

rreshqitshem, Tavoline te rrotullueshme, e zgjatshme me lartesi te rregullueshme ne lartesine afersisht 85/105 cm

Me kater rrota 2 prej te cilave me frena.

Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

10. Dollap pacienti

Përmasat(gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 55 x 200 cm

Skeleti dhe kanatet duhet te jenë prej materiali melamine me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Materiali të kete veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të skeletit dhe kanateve të jenë të veshura (bordura) me material plastik PVC. Kanatet të mbyllen me çeles. Në pjesën e brendshme të ketë tub për varjen e rrobave dhe ndarjeqe formojne dy hapësira ne pjesen e poshme. Të jetë i paisur me tapa plastike kunder gervishtjes. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

11. Tavolinë pune e thjeshtë

Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 140 x 80 x 75 cm

Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Në pjesën e brendshme në njërin krah ndodhet posti i tastierës e fiksuar me shina rrëshqitëse, në krahun tjetër ndodhen dy sirtare me gjerësi 45 cm ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me çeles. Montimi i tastierës duhet të jetë i thjeshtë dhe me mundësi zgjedhje të krahut të punës. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kabllave nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Tavolina të projektohet në një mënyrë që të minimizohet rreziku i dëmtimit të përdoruesve. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

12. Tavolinë pune per dhomat e mjekeve(vizitave)

Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 180 x 80 x 75 cm

Syprina melaminë me trashësi 32 mm. Veshje laminati me rezistencë te lartë kunder gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide dhe të rëndë. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kabllave nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Tavolina të projektohet në një mënyrë që të minimizohet rreziku i dëmtimit të përdoruesve. Të paktohen që të mos dëmtohen

gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

13.Karrige e thjeshte

Karriket të jenë dizenuar me një stil modern. Me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval 30 x 15 mm me spesor jo më të vogël se 1.3 cm me lyerje elektrostatische. Në pjesën e brendshme ndodhet një material plastik i cilësisë së lartë. Shpinorja dhe ndenjësja janë material plastik i cilësisë së lartë. Në pjesën e mbrapme kanë një mbulesë prej polietileni. Montohen në skelet metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jëtë në stof të cilësisë së parë ose lëkurë ekologjike. Karrigia të projektohet në mënyrë që të minimizojnë rrezikun e dëmtimit të përdoruesve. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

14.Karrige stafi/personeli, mjeku pune

Karriket rrotulluese të kenë shpinore të regjistrueshme me mekanizëm për ulje-ngritje me piston. Karrigia do të mbështetet mbi një bazament në formë ylli prej materiali plastik me 5 rrota në ekstremet e tyre. Rrotat të jenë me material plastik ngarkesë-mbajtës. Krahët mbështetës të karrikes të jenë plastikë dhe ngarkesë mbajtës. Tapiceria të jëtë në stof të cilësisë së parë ose lëkurë ekologjike. Karrigia të projektohet në mënyrë që të minimizojnë rrezikun e dëmtimit të përdoruesve. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

15.Dollap për dosje per receptionin

Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 80 x 45 x 180 cm

Skeleti dhe kanatet duhet të jenë prej materiali melaminë me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Sergjenët do jenë prej materiali melaminë me trashësi 2.5 cm. Materiali të ketë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Xokula do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjenëve dhe kanateve të jenë të veshura (borduara) me material plastik PVC. Kanatet të mbyllen me celes. Pjesa e brendshme të ndahet në 5 (pesë) hapësira me sergjenë me mundësi regjistrimi sipas nevojës. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë. Montimi dhe zmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

16. Dollap per ambjentet e dhomave te mjekteve ,infermierise, depove etj

Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 55 x 200 cm

Skeleti dhe kanatet duhet të jenë prej materiali melamine me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Materiali të ketë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të skeletit dhe kanateve të jenë të veshura (borduara) me material plastik PVC. Në pjesën e brendshme duhet të jete I ndare ne dy pjese njera per te varur rroba dhe tjetra raft. Të jetë i paisur me tapa plastike kunder gërvishtjes. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë

transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

17.Stola pritje tre vendeshe

14 cope te jene set Karrige Vizitorësh, të përbëra nga 3 karrige të lidhura bashkë, me material inoks/kromuar dhe me ndenjësë inoks/kromuar të lyera metalizato, me mbajtëse anësore.

4 cope do te jene me material druri dhe i veshur me tapiceri me dimensione 45x120 dhe lartesi 45 cm.

Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

18.Banak për reception

Përmasat(gjerësi x thellësi x lartësi): 250 x 70 x 110 cm

Banaku përbëhet nga syprina e madhe 250 x 70 cm mbi të cilën qendron syprina e vogël në lartësinë 38 cm me dimensione 250x 30 cm. E gjithë mobilja do të ndërtohet me material melamine 25mm. Ato kanë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Anësorja dhe ballorja e banakut do të ndërtohet po me të njëjtin material. Në të njëjtin plan, në lartësinë 38 cm nga syprina e madhe vendoset syprina e vogël me dimensione 30 x 250 cm, e cila është pjesë e mbështetjes së klientit. Të gjithë elementët e banakut të receptionit të jenë të borduara me material plastik PVC. Pjesë e receptionit është dhe një sirtarierë e lëvizshme, specifikimet teknike të së cilës i kemi dhënë më vete. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

19.Dollap Farmacie

Konstruksioni i dollapit duhet të jetë prej material melamine me spesor jo më të vogël se 18 mm me ngjyre të përcaktuar në kushtet e lidhjes së kontrates, me dy kapakë me xham nga lartësia 85 cm e sipër si dhe me dy kapakë dollapi në pjesën e poshtme. Pjesa e sipërme të ndahet në 4 hapësira nëpërmjet 3 sergjenave, kurse pjesa e poshtme të ndahet në dy hapësira horizontale nëpërmjet 1 sergjeni. Sergjenet të jenë me melamine jo më të vogël se 18 mm.

Dimensionet 80x45x190 cm.

Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës

20.Kosha per mbetje urbane

Kosh inoksi me volum mbi 8 L

21.Perde me mekanizem

Perde-roler me mekanizëm në anë, për uljen dhe ngritjen e saj, për dritare. Copa të jetë me material cilësor jo transparent dhe antibacterial.

Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës

22.Dollap garderobe

Përmasat(gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 55 x 200 cm

Skeleti dhe kanatet duhet te jenë prej materiali melamine me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Materiali të kete veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të skeletit dhe kanateve të jenë të veshura (borduara) me material plastik PVC. Kanatet të mbyllen me çeles. Në pjesën e brendshme të ketë tub për varjen e rrobave dhe ndarjeqe formojne dy hapësira ne pjesen e poshme. Të jetë i paisur me tapa plastike kunder gervishtjes. Dorezat e

kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

23. Dollap metalik garderober për në garderoben në bodrum

Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 92 x 40 x 195 cm

Dollap metalik me dyer duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenët ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

24. Raft metalik për kartotekën

Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 100 x 42 x 250 cm

Materiali i përdorur për këmbët do të jetë profil katror 30 x 30 x me spesor 1.6 deri 1.8 mm. Materiali i përdorur për vendosjen (sergjenat) e dosjeve do të jetë llamarinë e zezë me spesor 1.2 mm. Rafti do të ketë dhe një platformë melamine me shinë që do të shërbejë për një shikim të shpejtë të dosjesve vend. Ngjyra e raftit do të jetë gri metalizato. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

25. Kolltuqe komplet (3+2+1)

Skelet druri, stil modern dhe tapiceri me lëkurë ekologjike. Mbushje me sfungjer cilësor. Modeli, seti, ngjyra, etj, do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor në momentin e lidhjes së kontratës. Në komplet do të jenë një 3 vendësh një 2 vendësh dhe një kolltuk tek. Seti përfshin: Divani 3-vendësh: 200x90xH90 cm; Divani 2-vendësh: 170x90xH90 cm; Kolltuku: 120x90xH90 cm. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

26. Tavolinë mesje

Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): 110 x 55 x 45 cm

Materiali i përdorur do të jetë MDF e rimesuar. Syprina në pamjen ballore të saj do të jetë 10 cm. Këmbët e tavolinës përbëhen nga i njëjti material me atë të suprinës dhe janë të përmasave 10 x 10 x 35 cm. Ato montohen në skajet e suprinës së tavolinës dhe duhet të garantojnë një qëndrueshmëri të lartë, sidomos në pozicionin rrëshqitës. Tavolina të projektohet në një mënyrë që të minimizohet rreziku i dëmtimit të përdoruesve. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

27. Poltron pritje dyvendësh

Përmasat: Gjerësia: 186 cm, Thellësia: 95 cm, Lartësia: 94 cm

Të jetë me skelet druri. Të jetë i dizenuar me linja të drejta të stilit modern. Me tapiceri prej lëkure ekologjike të një cilësie të lartë. Sfungjeri i përdorur të jetë cilësor. Të paktohen që të mos

dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

28.Tavolinë e vecantë për sallë mbledhjesh

Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi):200 x 90 x 75 cm

Plani i siperm, syprina, duhet te jete melamine 2.5 cm. Spesoret anesor jane material melamine. Tavolinaduhet te jete lehtesisht e çmontueshme. Montimi dhe zmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Tavolina të projektohet në një mënyrë që të minimizohet rreziku i dëmtimin të përdoruesve.Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

29.Karrige per sallën e mbledhjes.

Karriket rrotulluese të kenë shpinore të regjistrueshme me mekanizëm për ulje-ngritje me piston. Karrigia do të mbështetet mbi një bazament në formë ylli prej materiali plastik me 5 rrota në ekstremet e tyre. Rrotat të jenë me material plastikngarkesë-mbajtës. Krahët mbështetës të karrikes të jenë plastikë dhe ngarkesë mbajtës. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkurë ekologjike. Karrigia të projektohet në mënyrë që të minimizojnë rrezikun e dëmtimit të përdoruesve.Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës

30.Karrike per sallat operatore dhe te lindjes

Karriket kërkohen të jenë rrotulluese, me ndenjësë mundësisht të rrumbullakët, me shpinore të ulët rreth 15 cm mbi nivelin e ndenjësës, me nivelim të rregullueshëm për ulje ngritje, me mbajtëse rrethore metalikepër vendosjen e këmbëve dhe rrota të vendosura në këmbëzat për lëvizje. Lartësia minimale dhe ajo maksimale do të jenë 44-54 cm. Materiali i ndenjësës është me mbushje sfungjeri dhe veshje sintetike, pjesa tjetër material metalik. Karrigia të projektohet në mënyrë që të minimizojnë rrezikun e dëmtimit të përdoruesve.Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

31.Pasqyrë muri për tualet

Përmasa 80x 60 cm, të jenë me korniza druri. Xhami i pasqyres të jetë i cilesise së lartë.Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës. Montimi sipas kërkesave të AK-ve.Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit

32. Stola (pupa per hollat e pritjeve)

Përmasat: Gjerësia: 40 cm, Thellësia: 40 cm, Lartësia: 45 cm

Të jetë me skelet druri.Të jetë i dizenuar me linja të drejta të stilit modern.Te jete I veshur me tapiceri .Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

33. Etazhier

Përmasat(gjerësi x thellësi x lartësi): 75 x 40 x 50 cm

Materiali i përdorur për këmbët do të jetë profil katror 30 x 30 x me spesor 1.6 deri 1.8 mm. Materiali i përdorur për pjesen e raftit (etazhierit) melamine me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës..Të paketohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

34. Pasqyre muri

3 nga pasqyrat do të jene rrethore me R=50 cm me strukture metalike.

1 nga pasqyrat do jete me dimesnion 65x190 me korniza druri. Xhami i pasqyres të jetë i cilesise së lartë.Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës. Montimi sipas kërkesave të AK-ve.Të paketohen që të mos dëmtohen gjatë transportit

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Afati i garancise: 1 (nje) vit për pajisjet e mobilimit,

Afati i garancise: 2 (dy) vjet për pajisjet mjekesore.

Në momentin e dorëzimit të pajisjeve, Kontraktori duhet t'a shoqërojë mallin me dokumentacionin përkatës që vërteton plotësimin e standardeve dhe specifikimeve teknike të kërkuara. Pajisjet duhet te jene te shoqeruara me manualet e perdorimit dhe manualet e servisit/sherbimit.

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

<input type="checkbox"/> Mall:		Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes
Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Loti 1: “F.V paisje mjekesore per Sallen e Operacionit dhe Reanimacion adult dhe neunatal për Maternitetin e Ri në Spitalin Rajonal Lezhë ”.

Nr	Emertimi i pajisjes	Njesia	Sasia	CMIMI	VLERA PA TVSH
1	Monitor pacienti	cope	10		
2	Monitor pacienti multiparametral	cope	1		
3	Tavoline operatore obst gjinek	cope	2		
4	Set anestezie	cope	1		
5	Llampe operatore	cope	2		
6	Defibrilator me monitor	cope	3		
7	Elektrobisturi monopolare dhe bipolare	cope	1		
8	Kolposkop	cope	1		
9	Inkubator per neonate me servo kontroll	cope	2		
10	Aparature CPAP per neonate me lageshtues	cope	1		
11	Njesi reanimimi per beba (radiant)	cope	2		
12	Pajisje Fototerapie	cope	2		
13	Krevat ngrohes	cope	3		
14	Dyshek fototerapie	cope	2		
15	Elektrobisturi e avancuar bipolare ultrasonike ose ekuivalentin e saj	cope	1		
16	Autokllave	cope	2		
17	ECG	cope	2		
18	Shiringe elektrike	cope	2		
19	Pompe infuzioni	cope	3		
20	Aspirator per neonate	cope	1		

Dokumentat Standarde të Tenderit

21	Aspirator kirurgjikal	cope	1		
22	Monitor RZF bebit (KARDIOTOKOGRAF)	cope	4		
23	Llampe baktericide	cope	2		
	Shuma pa TVSH				
	TVSH				
	Shuma me TVSH				

Loti 2: F.V paisje mjekesore per Urgjencen dhe Konsultorin për Maternitetin e Ri në Spitalin Rajonal Lezhë.

Nr	Emertimi i pajisjes	Njesia	Sasia	CMIMI	VLERA PA TVSH
1	Sistem Histeroskopie	cope	1		
2	Peshore Dixhitale per bebe	cope	4		
3	Mates transkutan per bilirubinen	cope	1		
4	Eko obstrike gjinekeologjike per konsultorin	cope	1		
5	Eko obstrike gjinekologjike portabel per urgjencen	cope	1		
6	Llampe anesore (mobile)	cope	5		
7	Llampe ekzaminimi (spot)	cope	5		
8	Set abrazio	cope	3		
9	Set lindje	cope	5		
10	Stativa	cope	50		
11	Laringoskop adult	cope	2		
12	Laringoskop pediatik	cope	2		
	Shuma pa TVSH				
	TVSH				
	Shuma me TVSH				

Loti 3: “F.V pajisje hotelerie spitalore për Maternitetin e Ri në Sp Lezhë.

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Karrel instrumentash Kirurgjikal	Cope	10		
2	Krevat reanimacioni	Cope	5		
3	Krevat vizite gjinekologjike	Cope	5		
4	Krevat manipulime gjinekologjike	cope	4		
5	Krevat lindje	cope	3		
6	Barrele	Cope	3		
7	Shtrat pacienti	Cope	50		

Dokumentat Standarde të Tenderit

8	Krevat per bebe	Cope	20		
9	Komodine Pacienti	Cope	50		
10	Dollap pacienti	Cope	30		
11	Tavoline pune e thjeshte per stafin mjekesor	Cope	19		
12	Tavoline pune per dhomat e mjekeve dhe zyrave	Cope	12		
13	Karrige e thjeshte	Cope	113		
14	Karrige stafi/personeli, mjeku pune	Cope	34		
15	Dollap dosjesh per receptionin	Cope	4		
16	Dollap per ambientet e dhomave te mjekeve, infermierise, depove etj	Cope	25		
17	Stola pritje pacientesh tre vendeshe	Cope	18		
18	Banak per reception	Cope	2		
19	Dollap farmacie	Cope	21		
20	Kosha per mbetje urbane	Cope	25		
21	Perde me mekanizëm(grila)	ml	96		
22	Dollap garderobe per personelin mjekesor	Cope	13		
23	Dollap metalik garderobe per ne garderoberen ne bodrum	Cope	18		
24	Raft metalik për dosje (kartoteke)	Cope	20		
25	Kolltuqe komplet (3+2+1)	Cope	2		
26	Tavolinë mesi	Cope	7		
27	Poltron pritje dyvendësh	Cope	5		
28	Tavolinë e vecantë për sallë mbledhjesh	Cope	1		
29	Karrige per sallën e mbledhjes	Cope	10		
30	Karrige per sallat operatore dhe te lindjes	Cope	10		
31	Pasqyre muri per tualet	Cope	20		
32	Stola (pupa per hollat e pritjeve)	Cope	12		
33	Etazhier	Cope	1		
34	Pasqyre muri	Cope	4		
	Shuma pa TVSH				
	TVSH				
	Shuma me TVSH				

Afatet e lëvrimit: Brenda 40 diteve nga data e lidhjes se kontrates.

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

Shtojca 14

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsytet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat – Tender i Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

- tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
